



UNIVERSITETI I PRISHTINES
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush Ndrëtesit e Rektoratit, D 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 133 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.:

395

Date:

12.03.2025

RAPORTI I VLERËSIMIT PËR DORËSHKRIMIN E PUNIMIT TË DIPLOMËS SË MASTER-it

Fakulteti	i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	Komunikacionit/Komunikacion Rrugor
Projektpropozimi	Metodologjia e grumbullimit, përpunimit të dhënave, për qëllim të modelimit të kërkesës për udhëtime me anë të sistemit GIS në qytetin e Prishtinës
Kandidati	Bsc. Egzona Qorri
Mentori	Prof.Ass.Dr. Ramadan Duraku
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e fakultetit	Datë: 00 Vendimi me nr.: 1185/2-3, Datë: 25/07/2024

Vlerësimi i dorëshkrimit:

Në bazë të vendimit të Dekanit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike , 1185/02-3 të datës: 25/07/2024 është formuar komisioni me këtë përbërje:

1. Prof. Asoc.Dr. Ferat Shala, kryetar,
2. Prof.Ass.Dr. Ramadan Duraku, mentor,
3. Prof. Asoc.Dr. Ramadan Mazrekaj, anëtar.

për vlerësimin e punimit Master me titull "Metodologjia e grumbullimit, përpunimit të dhënave, për qëllim të modelimit të kërkesës për udhëtime me anë të sistemit GIS në qytetin e Prishtinës" të kandidatës BSc. Egzona Qorri.

Pas kontrollimit të punimit të lartpërmendur Komisioni jep këtë:

RAPORT

Punimi me titull "Metodologjia e grumbullimit, përpunimit të dhënave, për qëllim të modelimit të kërkesës për udhëtime me anë të sistemit GIS në qytetin e Prishtinës", është hartuar në 10 kapituj dhe është ilustruar përmes 63 figurave dhe 11 tabelave.

Në kapitullin e parë - Hyrja, paraqet qëllimin e hulumtimit dhe rëndësinë e përdorimit të metodave moderne për menaxhimin e trafikut në qytetin e Prishtinës. Gjithashtu, ky kapitull ofron një pasqyrë të përgjithshme të strukturës së punimit.

Në kapitullin e dytë - **Përshkrimi i Gjendjes Ekzistuese**, analizon situatën aktuale të trafikut dhe infrastrukturës në Prishtinë, duke identifikuar sfidat dhe problematikat kryesore që kërkojnë zgjidhje. Ky kapitull shërben si bazë për formulimin e pyetjeve hulumtuese dhe përcaktimin e orientimit të studimit.

Në kapitullin e tretë - **Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS)**, trajton konceptet kryesore të GIS-it, historinë e zhvillimit të tij, mënyrat e përdorimit dhe aplikimet specifike në fushën e transportit dhe komunikacionit.

Në kapitullin e katërt - **Metodologjia e Zonimit të Qytetit të Prishtinës**, fokusohet në ndarjen e qytetit në zona të ndryshme përmes përdorimit të veglës së GIS-it, bazuar në kriteret e caktuara si densiteti i popullsisë, numri i të punësuarve, numri i vendeve të punës, trafiku dhe përdorimi i hapësirës urbane. Ky proces është thelbësor për organizimin dhe analizimin e të dhënave për qëllim të modelimit të kërkesës për udhëtime me anë të sistemit GIS në qytetin e Prishtinës.

Në kapitullin e pestë - **Grumbullimi dhe Përpunimi i të Dhënave**, përshkruan burimet e informacionit, metodat e grumbullimit dhe proceset e përpunimit të të dhënave për t'u përdorur në analizat e mëtejshme. Ky kapitull shpjegon teknikat dhe mjetet që përdoren për të siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave.

Në kapitullin e gjashtë - **Ndërtimi i Modelit GIS për qëllim modelimin e Kërkesës për Udhëtime**, përqendrohet në krijimin e një modeli të bazuar në GIS, përmes të cilit mundësohet interpretimi dhe analiza për qëllim të modelimit të kërkesës për udhëtime me anë të sistemit GIS në qytetin e Prishtinës. Ky model është mjet kyç për modelimin e kërkesës dhe planifikimin e infrastrukturës së transportit në qytetin e Prishtinës.

Në kapitullin e shtatë - **Përpunimi dhe analiza e rezultateve**, trajtohet analizimi i të dhënave të mbledhura dhe vlerësimi i efektivitetit të modeleve të krijuara. Ky kapitull është thelbësor për nxjerrjen e përfundimeve të qarta dhe formulimin e rekomandimeve për përmirësimin e kërkesës për udhëtime në qytetin e Prishtinës.

Në kapitullin e tetë - **Konkluzionet**, përmbledhen rezultatet kryesore të punimit dhe diskutohen rekomandimet për zbatimin e teknologjive të reja në menaxhimin e kërkesës për udhëtime dhe zhvillimin e infrastrukturës së transportit. Gjithashtu, ky kapitull ofron një analizë të mundësive të ardhshme për hulumtim në këtë fushë.

Në kapitullin e nëntë - Përfundimi, mbyll punimin duke ofruar një pasqyrë të shkurtër të gjetjeve dhe sugjerimeve të bëra gjatë hulumtimit. Theksohet rëndësia e përdorimit të GIS-it për modelimin e kërkesës për udhëtime në qytetin e Prishtinës dhe ndikimi pozitiv i kësaj teknologjie në menaxhimin e trafikut dhe planifikimin urban.

Në kapitullin e dhjetë - Literatura, e shfrytëzuar sipas renditjes numerike.


PËRFUNDIM

Në bazë të shqyrtimit të punimit Master, Komisioni për vlerësim konsideron se punimi është hartuar në nivel të duhur, i shtjelluar përmes figurave dhe tabelave.

Prandaj, Komisioni për vlerësimin e punimit Master, të kandidat-es BSc. Egzona Qorri, me titull "Metodologjia e grumbullimit, përpunimit të dhënave, për qëllim të modelimit të kërkesës për udhëtime me anë të sistemit GIS në qytetin e Prishtinës", mendon se i plotëson të gjitha kriteret për punim Master dhe mund të zhvillohen procedurat për diskutim publik.

Prishtinë, 11.03.2025

Komisioni:

1. 
(Prof. Asoc. Dr. Ferat Shala, kryetar)
2. 
(Prof. Asoc. Dr. Ramadan Mazrekaj, anëtar)
3. 
(Prof. Ass. Dr. Ramadan Duraku, mentor)

P.S.: Numri i faqeve shtohet sipas nevojës. Vendi, data dhe nënshkrimet vijnë në fund.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

DEPARTAMENTI: KOMUNIKACION

PROGRAMI: KOMUNIKACION RRUGOR



PUNIMI DIPLOMES MASTER

TEMA: “ Metodologjia e grumbullimit, përpunimit të dhënave, për qëllim të modelimit të kërkesës për udhëtime me anë të sistemit GIS në qytetin e Prishtinës”

Mentori:Prof.Ass.Dr.Ramadan Duraku

Kandidatija:Bsc.Egzona Qorri

Prishtinë, 2025

ABSTRAKT

Prishtina, si kryeqyteti i Kosovës, një shtet i ri, ka nisur një rrugë të rëndësishme drejt zhvillimit urban dhe transformimit në një qytet modern. Megjithatë, përballë rritjes së popullsisë dhe zhvillimit të infrastrukturës, qyteti has sfida të mëdha në menaxhimin e trafikut, sigurinë rrugore dhe mbrojtjen e mjedisit.

Ky punim synon të përdorë Sistemin Informativ Gjeografik (GIS) për të grumbulluar, menaxhuar dhe analizuar të dhënat gjeografike dhe hapësinore, duke ofruar një zgjidhje të lehtë dhe të integruar për mbështetje në zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe përmirësimin e menaxhimit të trafikut në kryeqytet.

GIS-i është një teknologji e avancuar që ndihmon në hartografimin kompjuterik dhe në krijimin e një kuptimi më të thellë të territoreve dhe përbërësve të tyre gjeografikë. Ky sistem përfshin mjete dhe komponentë të ndryshëm që mundësojnë analizimin efikas të informacionit hapësinor të një zone. GIS-i ka lehtësuar ndjeshëm procesin e vizualizimit të të dhënave në formën e hartave. Sot, kjo teknologji përdoret gjerësisht për zhvillimin e projekteve dhe në kërkimin e paraqitjen e të dhënave gjeografike. Programet kompjuterike që bazohen në GIS janë të pranishme në shumë sektorë të ndryshëm, përfshirë industrinë, ekonominë, administratën qendrore dhe lokale, si dhe shërbimet publike e private.

Qëllimi kryesor i këtyre sistemeve është të ndihmojnë në menaxhimin e burimeve dhe të mbështesin vendimmarrjen në fusha të ndryshme, duke mundësuar integrimin e të dhënave tabelare dhe atyre hapësinore. Përmes grumbullimit të të dhënave nga burime të ndryshme, përfshirë matje të trafikut dhe sondazhe me qytetarët, si dhe përpunimit të tyre në GIS, mundësohet identifikimi i zonave me problematika të trafikut dhe sigurisë. Gjithashtu, GIS-i lejon segmentimin e qytetit në zona të detajuara dhe zhvillimin e modeleve të transportit, të cilat ndihmojnë në optimizimin e rrjetit rrugor dhe uljen e ndikimeve mjedisore.

Ky hulumtim synon të kontribuojë në zhvillimin e Prishtinës si një qytet modern dhe të qëndrueshëm, duke ofruar zgjidhje të bazuara në të dhëna për sfidat me të cilat përballen qytetarët dhe autoritetet e transportit në një shtet të ri.

PËRMBAJTJA

- 1. PËRBLLEDHJE E PËRGJITHSHME**
 - 2. PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE**
 - 3. SISTEMI I INFORMACIONIT GJEOGRAFIK GIS**
 - 4. METODOLOGJIA E ZONIMIT TË QYTETIT TË PRISHTINËS**
 - 5. GRUMBULLIMI DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE**
 - 6. NDËRTIMI I MODELIT GIS PËR MODELIMIN E KËRKESËS PËR UDHËTIME NË QYTETIN E PRISHTINËS**
 - 7. PËRPUNIMI DHE ANALIZA E REZULTATËVE PËR QYTETIN E PRISHTINËS**
 - 8. KONKLuzionET**
 - 9. PËRFUNDIMI**
- LITERATURA